

---

# KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot më datë **18/07/2018**, bazuar në nenin 73 pika 1/b të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" – i ndryshuar dhe nenin 705 e vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", nënshkruhet kjo kontratë për shitjen e kuotave të shoqërisë "**BEAUTY INTERNATIONAL**" SHPK, me Nr. NUIS L12307029I, si më poshtë vijon:

## Neni 1

### Palët kontraktuese

1. **Z. Gentian FILAJ**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 13.07.1970, i identifikuar nga karta e identitetit nr. 033118975 dhe me nr. personal H00713048B, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i 20% të kuotave të shoqërisë "Beauty International" SHPK, **nga këtu e më poshtë referuar si "SHITËSI"**.

dhe

2. **Znj. Semela MEDIU**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 10.09.1990, e identifikuar nga karta e identitetit nr. 032040560 dhe me nr. personal J05910078C, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotëruese e 80% të kuotave të shoqërisë "Beauty International" SHPK, **nga këtu e më poshtë referuar si "BLERËSI"**.

## Neni 2

### Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitja nga shitësi kundrejt blerësit, të **20% (njëzetë përqind)** të pjesëve/kuotave të kapitalit të shoqërisë, me një vlerë totale prej **ALL 20.000 (njëzetë mijë lekë)**, që Shitësi zotëron në shoqërinë "BEAUTY INTERNATIONAL" SHPK me nr. NUIS L12307029I.

---

**Neni 3**

**Çmimi i shitjes**

Çmimi total i shitjes së kuotave është ALL 20.000 (njëzetë mijë lekë).

**Neni 4**

**Mënyra e pagesës**

Çmimi i shitjes së kuotave i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, është likuiduar prej blerësit.

**Neni 5**

**Detyrimet e shitësit**

Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotave, që ai kishte në shoqërinë "BEAUTY INTERNATIONAL" SHPK, kuota të cilat tashmë i kalojnë Blerësit.

Shitësi garanton se kuotat, të cilat shiten me këtë kontratë, nuk janë të lëna peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i tyre e gëzon të drejta të plota mbi to.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotat objekt i kësaj kontrate.

**Neni 6**

**Detyrimet e Blerësit**

Blerësi ka paguar çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 4 të kësaj kontrate.

Blerësi do të marrë të gjitha masat për të regjistruar transferimin e kuotave që Shitësi i kalon atij, në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 7**

**Hyrja në fuqi**



---


Kjo kontratë hartohet në 2 ekzemplarë, në gjuhën Shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.

Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

**SHITËSI**

**Gentian FILAJ**

Handwritten signature of Gentian Filaj in black ink, featuring a stylized, cursive script.

**BLERËSI**

**Semela MEDIU**

Handwritten signature of Semela Mediu in black ink, featuring a stylized, cursive script with a large loop.